

# Informacion-pyetëor për pacientët

## Çfarë është Tomografia e Kompjuterizuar (TK, CT)



MEDIZINISCH  
RADIOLOGISCHES  
INSTITUT

### Shumë e nderuara paciente, shumë i nderuar pacient

Ju nga mjeku/mjekja Juaj jeni rekomanduar për një Tomografi të Kompjuterizuar (CT). Me këtë fletë për informacione dëshirojmë që t'Ju njoftojmë me disa informacione të rëndësishme për këtë kontroll.

### Çfarë është Tomografia e Kompjuterizuar - CT?

CT është një metodë me të cilën bëhen imazhe (fotografi), dhe varësisht nga problemi klinik (detyra diagnostike), bëhet e qartë shtresë pas shtrese (fotografi me prerje transversale) një zonë e caktuar e trupit Tuaj. Me atë rast futen në veprim rrezet rëntgen. Organe të veçanta dhe raporti i organeve me njëri-tjetrin si dhe vatrat e mundshme të sëmundjes paraqiten ashtu siç janë. Kjo është me rëndësi për mjekimin e mëtejshëm.

### Si zhvillohet një CT?

Kohëzgjatja e kontrollit varet nga zona që kontrollohet dhe nga detyra diagnostike (pasqyra klinike) e mjekut Tuaj, i cili e kryen mjekimin. Në të shumtën e rasteve kontrolli i përgjithshëm zgjat (përfshi edhe parapërgatitjen) jo më shumë se 30 minuta. Kontrolli i vërtetë i Tomografisë së Kompjuterizuar zgjat vetëm disa sekonda.

Për kontroll do të shtrihen në një minder (shtrojë) speciale, e cila në vijim lëviz ngadalë përmes aparatit CT.

### Çfarë duhet të kem kujdes gjatë CT-së?

Është e rëndësishme që gjatë përgatitjes së fotografive mundësisht të mos lëvizni dhe t'i ndiqni si duhet komandimet e mundshme të frymëmarrjes (marrjen, nxjerrjen, ndaljen e ajrit). Gjatë tërë kohës së kontrollit Ju do të jeni nën mbikëqyrjen e personelit profesional, dhe komunikimi në hapësirën e kontrollit do të sigurohet gjithnjë edhe kur dyert janë të mbyllura. Kontrollit me CT mund t'i nënshtrohen pa kurrfarë problemesh edhe pacientët që frikohen nga zënia e frymës (agorafobi)!

### Përse nevojitet lënda e kontrastit (mjet kontrasti)?

Kontrolli CT me lëndë kontrastit është i nevojshëm në varësi nga detyra diagnostike (pasqyra klinike) e mjekut Tuaj. Ekzistojnë lëndë të ndryshme kontrastit, të cilat përdoren veç e veç ose të kombinuara: lëndë kontrastit që jepet përmes pijes ose përmes zorrës së trashë (paraqitje më e mirë e barkut dhe e zorrës) ose që jepet përmes një vene të krahut (paraqitje e enëve të gjakut dhe kontrastit i përmirësuar në organet/pjesët e buta).

### Çfarë efektesh anësore dhe komplikime mund të shfaqen?

Gjatë dhënies së lëndës kontrastive përmes një vene të krahut, mund të ndieni dhimbje sikur te çdo injektim ose të keni gjakrrjedhje në vendin e shpimit. Infektimet janë shumë të rralla. Në qoftë se gjatë injektimit të lëndës së kontrastit në vendin e shpimit vëreni ndonjë ënjtje të krahut, për këtë menjëherë duhet të na informoni: Rrallëherë mund të vijë deri te ajo, që lënda e kontrastit të

rrjedhë nëpër venë dhe të shpërndahet në pjesët e buta të krahut. Kjo mund të shkaktojë një ënjtje të dhimbshme, e cila mund të ndalet pas disa ditësh dhe kjo ndonjëherë ka nevojë për një mjekim përkatës.

Si reaksione normale ndaj injektimit të lëndës kontrastive janë: një ndjenjë e ngrohtësisë në stomak dhe një shije pak e hidhur metalike në gojë.

Herë pas here dhënia e lëndës kontrastive shkakton gjithashtu teshtimë, ekzemë ose të pështjellë. Këto efekte anësore janë me kohëzgjatje të shkurtë dhe eventualisht kërkojnë një terapi me barna, të cilën e rekomandon radiologu (rëntgenologu). Efektet anësore serioze nga lëndët kontrastive moderne, si gulçima (vështirësi në frymëmarrje) dhe vështirësi në qarkullimin e gjakut ose ngërçe, janë shumë të rralla.

Rreziku i kontrollit me CT në krahasim me dobitë, është shumë i vogël dhe ai testohet me kujdes para çdo kontrolli. Megjithatë, po qe se shfaqen efekte anësore, në dispozicion e keni ndihmën e menjëhershme mjekësore.

Të gjitha kontrollet CT janë të lidhura me një ekspozim të rrezatimit. Ne i marrim të gjitha masat paraprake, që këtë rrezatim ta minimizojmë sa më shumë që të jetë e mundur.

Para çdo kontrolli CT do t'Ju jepet një pyetësor, të cilin do t'Ju lusim që ta lexoni me kujdes, ta plotësoni dhe të na ktheni neve prapë.

**Po qe se keni pyetje të tjera, Ju lutemi, kërkonit që për këto të merrni përgjigje nga mjeku ose mjekja që e kryen kontrollin. Ata për këtë me kënaqësi qëndrojnë në dispozicionin Tuaj!**

# Pyetëtori për pacientët

## Tomografia e Kompjuterizuar (CT)



MEDIZINISCH  
RADIOLOGISCHES  
INSTITUT

### Shumë e nderuara paciente, shumë i nderuar pacient

Ju nga mjeku/mjekja Juaj jeni rekomanduar për një Tomografi të Kompjuterizuar (CT). Ju lutemi që ta lexoni informacionin tonë për pacientët, i cili ka të bëjë me CT, t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme me ndërgjegje të plotë dhe në fund ta nënshkruani pyetësin.

Po qe se keni pyetje të tjera, Ju lutemi, kërkoni që për këto të merrni përgjigje nga mjeku ose mjekja që e kryen kontrollin. Ata për këtë me kënaqësi qëndrojnë në dispozicionin Tuaj!

Mbiemri:

Emri:

Data e lindjes:

### A

#### Pyetje të përgjithshme

Pesha:

kg

Po

Jo

Për gratë: A jeni apo a mund të mbeteni shtatzënë?

### B

#### Pyetje që kanë të bëjnë me dhënien intravenoze të lëndës kontrastive

Ju lutemi shënojeni me x, nëse Ju vuani apo keni vuajtur nga njëra prej sëmundjeve të mëposhtme

Po

Jo

Sëmundje e gjëndrës tiroide?

Alergjitë? (Ju lutemi ta parashtroji pasaportën për alergji, po qe se e posedoni një të tillë)

A keni qenë ndonjëherë i hospitalizuar (i shtrirë në spital) për shkak të ndonjë reaksioni të rëndë alergjik?

Sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes (astmë, gulçimë, emfizemë)?

Sëmundje të veshkave / pengesë në funksionimin e veshkave ose operacion të veshkave në të kaluarën?

Tension arterial i lartë (hipertoni)?

Sëmundje e sheqerit (diabet)?

A merrni rregullisht hollues të gjakut (kundërpiksës) ose barna kundër sëmundjes së sheqerit (diabet)?

Nëse po, çfarë?

A keni marrë ndonjëherë lëndë kontrastive në venë përmes injektimit?

Në rast se po: A e ka pranuar (duruar) mirë trupi Juaj lëndën e kontrastit?

e plotëson personeli profesional:

Creatinine:

µmol/l

Clearance (eGFR):

ml/min

Unë i kam kuptuar informacionet, në të gjitha pyetjet jam përgjigjur me ndërgjegje të plotë dhe jam dakord me kryerjen e CT (Tomografisë së Kompjuterizuar).

Data:

Nënshkrimi:

Viza MTRA:

